




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

**DREJTORIA E NDIHMËS  
JURIDIKE FALAS**



**KOLEGJI  
UNIVERSITAR  
QIRIAZI**

**KOLEGJI UNIVERSITAR  
"QIRIAZI"**

Nr. 376/2 Prot.

Tiranë, më 30/09/2020

Nr. 170 Prot.

Tiranë, më 30/09/2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE**

Sot më datë, 30.09.2020, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

**Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**, me adresë: Rt. Barikadave, Nd. 18, Hyrja 6, Zyra nr. 10-III- Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Ergys Qirici

*dhe*

**Kolegjit Universitar Qiriazi, Fakulteti i Drejtësisë** me adresë: Rruga Taulantet, Kodër-Kamëz, Tirana 1029, përfaqësuar nga Prof. Dr. Agim Binaj

Palët në këtë marrëveshje bien dakord si më poshtë:

Neni 1

### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Kodin Civil, Pjesën V, Titulli I, Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” neni 8, pika “e”.

Neni 2

### **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje është ofrimi i ndihmës juridike parësore sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.

Neni 3

### **Përkufizime**

Në këtë marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ndihma juridike parësore” ka të njëjtin kuptim sipas nenit 3 të pikës “b” të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. “Palët “ janë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Universiteti pranë të cilit është ngritur klinika ligjore.
3. “Regjistri i kërkesave dhe vetë deklarimeve” është formati i regjistrit i miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhër Nr. 225, datë 25.03.2019.
4. “Sistemi unik i të dhënave” është sistemi elektronik online për ngarkimin e të dhënave, i aksesueshëm nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Neni 4

### **Të drejtat dhe Detyrimet e Fakultetit të Drejtësisë**

1. Fakulteti i Drejtësisë pranë të cilit është ngritur klinika ligjore do të ofrojë ndihmën juridike parësore sipas procedurave ligjore për dhënien e ndihmës juridike parësore të parashikuara në nenin 17 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

2. Klinikë ligjore do të mbajë, plotësojë dhe përditësojë regjistrin e vetëdeklarimeve të personave që kanë aplikuar të përfitojnë ndihmën juridike parësore. Regjistri do të mbahet në mënyrë elektronike. Ngarkimi i të dhënave do të bëhet edhe në sistemin Unik të të dhënave.

3. Klinikë ligjore do të dërgojë të dhëna periodike çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar / përfituar ndihmën juridike. Të dhënat do të dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

4. Përzgjedhja e studentëve që do të përfshihen në ofrimin e ndihmës juridike parësore pranë klinikës ligjore do të bëhet sipas rregullave të Klinikës së Ligjit . Në çdo rast numri i studentëve nuk mund të jetë më shumë se numri i lejuar për grup sipas rregullave të Fakultetit të Drejtësisë dhe Klinikës së Ligjit.

5. Klinikë ligjore mund të japë opinione, sugjerime, të kërkojë informacione apo ndihmë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për çështje /probleme që lidhen me ofrimin apo përmirësimin e ndihmës juridike parësore.

6. Klinikë ligjore ndërmerr fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut veçanërisht informimin e studentëve të universitetit / fakultetit mbi kriteret dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike parësore.

7. Klinikë ligjore ka të drejtë të përfitojë financime nga donatorë të ndryshëm të cilët ofrojnë mbështetje në fushën e Ndihmës Juridike.

8. Klinikë e ligjit ofron zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikë mban arkivin elektronik dhe është e pajisur me mjetet minimale të punës. Për aq sa është e mundur Klinikë, ofron shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standarteve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrisë të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike”.


Neni 5

### **Të drejtat dhe Detyrimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**

1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) do të ofrojë kushte për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë klinikës ligjore, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

2. Për aq sa është e mundur do të sigurojë informacione, këshillime apo ndihmën e kërkuar nga klinikë ligjore për zgjidhjen e problemeve me të cilat do të përballlet kjo e fundit gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë nga klinikë ligjore informacione apo të dhëna periodike.



4. Mbështet klinikat ligjore dhe me kërkesë të kësaj të fundit merr pjesë në fushata për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut.

#### Neni 6

##### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacione, të dërgojnë apo marrin të dhëna të ndryshme përmes postës elektronike apo çdo formë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Për këtë qëllim palët do të caktojnë personat e kontaktit me të dhënat si më poshtë:
  - Për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas: Personi i kontaktit Z. Ilberjan Durmishi nr. Cel. 0675500812; e-mail: [ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al](mailto:ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al); [dnj@drejtesia.gov.al](mailto:dnj@drejtesia.gov.al).
  - Për klinikën ligjore: Personi i kontaktit znj. Sonila Kamami, nr. Cel. 0692336193, e-mail: [sonilakamami@gmail.com](mailto:sonilakamami@gmail.com).
3. Në çdo rast palët njoftojnë për ndryshimin e të dhënave dhe personit të kontaktit.

#### Neni 7

##### **Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti**

1. Palët marrin përpunim të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë dhënies së ndihmës juridike parësore.
2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuarve të ndihmës juridike parësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 8

##### **Ndryshimi dhe zgjidhja e marrëveshjes**

1. Palët janë të lira të propozojnë ndryshimet e kushteve të kësaj marrëveshjeje.
2. Me njoftimin me shkrim, çdo palë në çdo kohë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje pasi të këtë njoftuar paraprakisht palën tjetër.

#### Neni 9

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre. Nëse kjo nuk është e mundur palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit mes palëve.

Neni 11

### Të ndryshme

1. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.
2. Çështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë marrëveshje do të rregullohen sipas Pjesës V, Titulli I, të dispozitave të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

**PËR**

**DREJTORINË E NDIHMËS**

**JURIDIKE FALAS**

përfaqësuar nga

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Z. Ergys Qirici**



**PËR**

**KOLEGJIN UNIVERSITAR QIRIAZI**

përfaqësuar nga

**REKTORI**

**Prof. Dr. Agim Binaj**

